



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13206 Prot.

Fier, më 16.12 2024

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e **Hënë datë 23.12.2024 në orën 12:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **26.11.2024**
3. Projekt – vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Nëntor 2024"
4. Projekt – vendim: "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë Fier, të Funksioneve dhe të Shërbimeve, të Bashkisë Fier"
5. Projekt – vendim: "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027 përfundimtar, dhe miratimin e Buxhetit të Vitit 2025, për Bashkinë Fier"
6. Projekt – vendim: "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për Vitet 2026-2028, dhe Buxhetit vjetor të Bashkisë Fier"
7. Projekt – vendim: "Për miratimin e bursave të shtetit, për nxënësit që ndjekin programet mësimore, në arsimin parauniversitar publik për vitin arsimor 2024-2025"
8. Projekt – vendim: "Për skualifikimin nga përfitimi i programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, të familjes së znj. Klodjana Bajramaj (Linfaj), miratuar si familje përfituese me VKB nr.05.datë.30.01.2024"
9. Projekt – vendim: "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.69 datë 30.06.2023, "Për miratimin e Komisionit të Strehimit"

10. Projekt – vendim: “Për miratimin e prishjes së objektit të shkollës së vjetër “5 Dëshmorët” në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier, ”
11. Projekt – vendim: “Për studimin tekniko- ekonomik për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes qe prek ndërtimi i nën/stacionit të Hoxharës”
12. Projekt – vendim: “Për trajtimin e qënëve të rrugës”
13. Projekt – vendim: “Për miratimin e dhënies pa kundërshpërblim të pasurisë nr.3/257 –B1, zk nr. 8534, me sipërfaqe 610 m2 e llojit “Bodrum”, ndodhur në Lagjen “Apollonia”, pronë e Bashkisë Fier, shoqatës “Bilardo Apollonia Fier”, me qëllim përdorimin dhe shfrytëzimin vetëm për veprimtari dhe aktivitete sportive si qëndër ditore për moshën e tretë.
14. Projekt – vendim: “Për një ndryshim në projektin: “Ndërtim i KUZ-së Lagja, “Afrim” Bashkia Fier”
15. Projekt – vendim: “Për miratimin e procedurës për ndërtimin e strukturës “Stacion Pompimi Çeligrad” në funksion të realizimit të projektit “Ndërtim i KUZ – së, lagja “Afrim” në pasurinë nr. 10/546 zk. 8533 pronë e Bashkisë Fier”.
16. Projekt – vendim: “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Veko” sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit “Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike” në pronat e Bashkisë Fier
17. Projekt – vendim: “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Shaqir Sulejmani, lagjia”15 Tetori”, Njësia Administrative nr. 3, për dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga zjarri i datës 23.10.2024”
18. Projekt – vendim:”Për miratimin e financimit të trajtimit ushqimor për sportistin e nivelit të lartë Julian Xhafa”
19. Projekt – vendim:”Për miratimin e shpërblimit të boksierit Aleksanër Kallashi” I cili ka fituar dy tituj europian në federatën UBO dhe UBF”
20. Projekt – vendim: “Për miratimin e dhënies së një ndihme financiare prej 5000 lekë për 1200 familje në nevojë”
21. Projekt – vendim: “Për dhënie ndihme të menjëherëshme Gjinovëfa Saliq ”
22. Diskutime dhe komente

Kryetar Këshilli

Antoneta Çunaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr.

Fier në 16/12/2024

VENDIM NR. 20 DATË 16/12/2024

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 "Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit", Kreu 2, neni 22 "Kryesia e Këshillit" neni 1, 3, 4

VENDOSI:

- 1-Miratimin e Rendit paraprak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 23/12/2024. Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraprak të Ditës.
- 2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.
- 3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Antoneta Çunaj

2-Endri Jaupaj

3-Fatbardha Merkaç

4-Evis Sema

5-Kreshnik Dapi

6-Arben Çuko